

Në bazë të nenit 172 të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 82/2018), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Fakultetin e Shkencave Islame, si dhe në mbështetje të nenit 162 të Fakultetin e Shkencave Islame, dhe në bazë të Vendimit të Këshillit mësimor – shkencor të Fakultetin e Shkencave Islame të mbajtur më date 27.11.2018, shpallet:

KONKURS

Për zgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore shkencore në Fakultetin e Shkencave Islame - Shkup

Shpallet Konkurs për zgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore shkencore në Fakultetin e Shkencave Islame - Shkup:

1. Një mësimdhënës për lëndën, Historia e së Drejtës Islame.
2. Një mësimdhënës për lëndën, Fikhul Ibadat dhe Usuli fikhu.

Kushtet për thirrjen mësimore-shkencore docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar:

- Thirrje mësimore – shkencore, me Vendim të organit kompetent, nëse e posedon;
- Diplomë për gradën shkencore doktor i shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet;
- Kandidatët që konkurrojnë duhet të kenë kontinuitet në studimet nga fusha përkatëse;
- Listë të punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara, si dhe kopje të punimeve të publikuara;
- Ta dorëzojë punimin e doktoratës;
- Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj;
- Njohje të gjuhës shqipe - shkrim dhe lexim;
- Certifikatë nga libri amë i të lindurve;
- Biografi e shkurtër;
- Certifikatë e shtetësisë.

***Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore dhe të bashkëpunëtorëve, të parapara me nenet 166 dhe 170 të Ligjit për arsimin e lartë.**

***Fletëparaqitjen bashkë me dokumentet e nevojshme, kandidati duhet t'i dorëzojë në afat prej 5 ditë pune, nga dita e shpalljes së Konkursit, në Dekanatin Fakultetin e Shkencave Islame – Shkup, në adresën: f. Kondovë Shkup.**